

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	NATO gati të përgjigjet ndaj sulmeve hibride ruse/ SHBA kërkon më shumë përgjegjësi nga Evropa
ADRESA	https://piranjat.al/bota/nato-gati-te-pergjigjet-ndaj-eve-hibride-ruse-shba-kerkon-me-shume-perg-i105908
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	24 shtator 2026, 18:39:56 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	24 shtator 2026, 18:32:56 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	c8a52c3d31ba7d01192ee330124e9ede9f85a0e0653fa4a439d7e1e54c074c88
TEKSTI	76811216b7243df4de350e7a4ed74897cc78b37a0801aa6c883fcc73b85561b6
PAMJA	52b46c09e52bc9784d8ca9a847c0e3c99884b8cbb8c2c5ab1d55b1958d08e1de

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	ab89c5670cd518dfd62bee976ccc36bcb388a70ded3409bd014863f271f1848e
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	1385e7008e03de6abe2f8860ad6394539cccd8b72b1ba567a2f7f8b6825304
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/ab89c5670cd518dfd62bee976ccc36bcb388a70ded3409bd014863f271f1848e>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

[SYRI LIVE](#)



Flash: [trupi i shqiptarit nga](#) ■ [naten mes të mërkurës dhe të](#) ■ [kanabisit në Shqipëri](#) ■ [fundit, duke sekuestruar](#) ■ [re per naftën/ Efekti](#) ■ [euro të tjera në vit barra fiskale nga](#) ■ [ndodhi në Sarandë, e cila nuk](#) ■ [e gazetares Vjolanda Peca nga](#) ■ [protestës së zhvilluar sot në](#)

[BOTA](#)

NATO gati të përgjigjet ndaj sulmeve hibride ruse/ SHBA kërkon më shumë përgjegjësi nga Evropa

Piranjat Përditësimi i fundit 24 Shtator 2026, 20:32



NATO është e përgatitur të përgjigjet ndaj sulmeve hibride dhe akteve të sabotazhit që synojnë vendet evropiane, ka deklaruar sekretari i përgjithshëm i aleancës, Mark Rutte, pas paralajmërimeve të reja për aktivitetet ruse.

Rutte tha se NATO ka në dispozicion opsionet e nevojshme për t'iu përgjigjur kërcënimeve në fushën kibernetike dhe formave të tjera të luftës hibride. Ai i bëri këto deklarata në një aktivitet në Nju Jork, ndërsa aleanca po përballlet me shqetësime në rritje lidhur me incidentet e raportuara në Evropë.

Sipas Rutte-s, shtimi i incidenteve të tilla lidhet me situatën e luftës në Ukrainë. Ai u bëri thirrje gjithashtu vendeve anëtare të vazhdojnë mbështetjen për Ukrainën.

Deklaratat e sekretarit të përgjithshëm të NATO-s erdhën pas paralajmërimeve nga inteligjenca daneze për rritjen e rrezikut të veprimeve ruse ndaj vendeve të NATO-s. Raportime të tjera mediatike kanë folur edhe për skenarë të mundshëm të përdorimit të dronëve rusë në Evropën Jugore, por këto raportime nuk paraqesin një sulm të konfirmuar.

Në të njëjtën kohë, sekretari amerikan i Mbrojtjes, Pete Hegseth, ka kërkuar që aleatët evropianë të marrin një rol më të madh në mbrojtjen konvencionale të kontinentit.

Kjo qasje është pjesë e konceptit të quajtur "NATO 3.0", përmes të cilit SHBA-ja dhe NATO synojnë një aleancë ku Evropa dhe Kanada marrin më shumë përgjegjësi për sigurinë e tyre, ndërsa lidhja transatlantike vijon të mbetet pjesë qendrore e strukturës së aleancës.

Në kuadër të këtij koncepti, Hegseth ka theksuar se aleatët evropianë duhet të kenë kapacitete të besueshme për mbrojtjen konvencionale dhe të investojnë më shumë në forcat ushtarake dhe industrinë e mbrojtjes.

Ndërkohë, rishikimi amerikan i angazhimit ushtarak në Evropë po shqyrton edhe vendosjen e ardhshme të forcave amerikane në kontinent. Sipas Reuters, procesi pritet të zgjasë disa muaj dhe synon, ndër të tjera, rritjen e përgjegjësisë së aleatëve evropianë për mbrojtjen e tyre.

Në këtë kuadër, NATO po e orienton gjithnjë e më shumë vëmendjen te forcimi i mbrojtjes ajrore dhe kundër dronëve, siguria kibernetike dhe mbrojtja e infrastrukturës kritike, përfshirë rrjetet energjetike dhe sistemet digjitale.

Artikuj te sugjeruar

BOTA 24 Shtator 20:25

[SHBA-ja mund të ndër marrë veprime ushtarake ndaj Kanadasë/ Carney: Do të ishte e papërgjegjshme të mos përgatiteshim](#)

Kryeministri kanadez Mark Carney ka deklaruar se qeveria e tij ka shqyrtuar edhe mundësinë e një veprimi ushtarak amerikan kundër Kanadasë...

BOTA 24 Shtator 19:48

[Xi i drejtohet Trumpit: Le të bashkëjetojmë në paqe, konkurrenca duhet të ketë kufij](#)

Pekini dhe Washingtoni duhet të "forcojnë komunikimin e tyre", tha Presidenti kinez Xi Jinping, duke theksuar nga Shtëpia e Bardhë...

BOTA 24 Shtator19:27

[VIDEO/ 92-vjeçari i paralizuar goditet me shkop gome dhe Taser nga policët](#)

Dy policë që përdorën sprej me piper, shkop gome dhe armë Taser ndaj një 92-vjeçari me një këmbë të amp...

BOTA 24 Shtator18:32

[3 vjet nga sulmi në Banjaskë, BE: Keqardhje që Serbia s'ka ndërmarrë hapat e nevojshëm](#)

Tre vjet pas sulmit të armatosur në Banjaskë të Zveçanit, Bashkimi Evropian i ka bërë thirrje sërish Serbisë që...

BOTA 24 Shtator18:28

[VIDEO/ 50 nxënës grabisin dyqanin me zbritje çmimesh, terror për 10 minuta mes klientëve dhe stafit](#)

Ata u takuan pas përfundimit të mësimit dhe vendosën të bastisin një supermarket. Rreth 50 të rinj hynë në një...

BOTA 24 Shtator18:23

[Trump fton Xi në Zyrën Ovale: Krenar për raportin me Kinën, mes dy vendeve tona hapet një kapitull i ri](#)

Presidenti amerikan Donald Trump ka pritur në Shtëpinë e Bardhë homologun e tij kinez, Xi Jinping, në një ceremoni të shoqë...

BOTA 24 Shtator18:16

[A do të shkosh në Moskë për të takuar Putinin? Zelensky: Vetëm me një raketë të mallkuar!](#)

Me një frazë të shkurtër, por të prerë, Volodymyr Zelensky e hodhi poshtë ofertën ruse për të udhëtuar në...

BOTA 24 Shtator18:14

[Biznesmenët kinezë “mbeten” jashtë avionit, misteri diplomatik që po tensionon takimin Xi-Trump](#)

Në fund, ata mbeten jashtë avionit, të paktën nga ai zyrtar. Një situatë që ngjan me një mister diplomatik dhe që...

BOTA 24 Shtator18:06

[Gjermania nis hetimet ndaj një 105-vjeçari. Ja për çfarë dyshohet](#)

Një burrë 105-vjeçar është nën hetim nën dyshimin se është bashkëpunëtor në vrasje të shumë...

BOTA 24 Shtator18:05

[12 vite pas aksidentit, bashkëshortja e Michael Schumacher rrëfen dhimbjen dhe jetën e tyre larg syrit të publikut: Kur dëgjoj këngën tonë, qaj](#)

Pas 12 vitesh nga aksidenti i rëndë që ndryshoi jetën e Michael Schumacher, bashkëshortja e tij, Corinna, ka dhënë një r...

ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 23 Shtator

[U vra nga pronari italian i banesës, del autops...](#)

Pak ditë pas vrasjes së 36-vjeçarit shqiptar Gjovalin Lazri nga pronari italian i një banese, mediat italiane japin të tjera detaje p...

AKTUALITET 24 Shtator

[Atentati ndaj vëllait të Fabio Dushkut/ Aksioni...](#)

Policia greke ka zhvilluar një aksion në Selanik, ku ka arrestuar tre shtetas shqiptarë të dyshuar për përfshirje në një...

AKTUALITET 23 Shtator

[“Ergys Agasi filmonte video gjatë takimeve në z...](#)

Gazetarja Anduena Llabani, ndau detaje të tjera në lidhje me hetimet e SPAK-ut në dosjen ku është përfshirë edhe drejtoresha ...

Nga Xhuljan Ferzaj INVESTIGIME 23 Shtator11:40

[EKSKLUZIVE/ Eskortat e huaja “mbysin” Tiranën: Si vajzat nga Brazili, Kolumbia e Vietnamit ofrojnë shërbime sek*uale për 50-150 euro](#)


Prostitucioni me shtetase të huaja po shfaqet gjithnjë e më hapur në disa prej qyteteve kryesore të Shqipërisë. Përmes...

video




PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 1





PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 1



“Dua 120 mijë euro”/ Si u zaptua prona në rrugën e Durrësit, zbardhet skema e mashtrimit



Tmerri i 40-vjeçares / Si u shndërrua njohja e re në përndjekje, shantazh dhe denigrim në rrjet





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.